



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (ZKM) NR. 01/2024
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E
VENDEVE TË PUNËS NË INSPEKTORATIN E MINISTRISË SË
DREJTËSISË¹

¹ Rregullore (ZKM) Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 011/2024, të datës 31.01.2024.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 28 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 9 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 8 dhe 9 të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR.01/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË INSPEKTORATIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: Inspektorati).

Neni 2 Fushëveprimi

1.Kjo Rregullore zbatohet nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit janë të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSPEKTORATIT

Neni 3 Misioni i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë

Misioni i Inspektoratit është mbikëqyrja e punës së Institucioneve Korrektuese dhe Drejtorive Rajonale Sprovuese me qëllim të sigurimit të sistemit unik të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Neni 4
Struktura organizative e
Inspektoratit të Ministrisë Drejtësisë

1. Struktura organizative e Inspektoratit, është si vijon:
 - 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 - 1.2. Divizionet.
2. Numri i përgjithshëm i të gjithë të punësuarve në Inspektorat është njëzetekatër (24).

Neni 5
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2. Zyrtar i lartë ligjor;
 - 1.3. Zyrtar administrativ.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Lartë Ligjor dhe të Zyrtarit Administrativ në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarë publik.
4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është tre (3).

Neni 6
Divizionet e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë

1. Në kuadër të Inspektoratit të Ministrisë Drejtësisë funksionojnë divizionet si në vijim:
 - 1.2. Divizioni për mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese;
 - 1.3. Divizioni për mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit;
 - 1.4. Divizioni për mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese.

Neni 7
Divizioni për mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese janë:
 - 1.1. Zbaton objektivat e përcaktuara të punës për mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese;
 - 1.2. Zbaton Planin Vjetor të Inspektimit në fushat e përcaktuara të mbikëqyrjes së Qendrave Korrektuese sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 1.3. Ofron rekomandime në fushat e inspektimit për Qendrat Korrektuese;
 - 1.4. Harton raport për vlerësimin vjetor të Qendrave Korrektuese.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Qendrave korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese është tetë (8).

Neni 8

Divizioni për Mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit janë:
 - 1.1. Zbaton objektivat e përcaktuara të punës së Divizionit për mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit;
 - 1.2. Zbaton Planin Vjetor të Inspektimit në fushat e përcaktuara të mbikëqyrjes së Qendrave të Paraburgimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 1.3. Ofron rekomandime në fushat e inspektimit për Qendrat e Paraburgimit;
 - 1.4. Harton raport për vlerësimin vjetor të Qendrave të Paraburgimit.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit është gjashtë (6).

Neni 9

Divizioni për Mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese janë:
 - 1.1. Zbaton objektivat e përcaktuara të punës së Divizionit për mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese;

1.2.Zbaton Planin Vjetor të Inspektimit në fushat e përcaktuara të mbikëqyrjes së Drejtorive Rajonale Sprovuese sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

1.3.Inspekton zbatimin e planit individual të mbikëqyrjes;

1.4.Inspekton mënyrën e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative që janë kompetencë e Shërbimit Sprovues të Kosovës;

1.5.Ofron rekomandime në fushat e inspektimit për Drejtoritë Rajonale Sprovuese;

1.6.Harton raportin për vlerësimin vjetor të Drejtorive Rajonale Sprovuese.

2.Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Sprovues të Kosovës i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese është shtatë (7).

Neni 10

Funksionet e brendshme mbështetëse

Shërbimet e përgjithshme, të teknologjisë së informimit, logjistikës, të buxhetit, financave, prokurimit dhe të burimeve njerëzore për Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, kryhen nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë, sipas Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, sipas paragrafit 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8 të nenit 7.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1.Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin përkatës për shërbimin civil brenda kategorisë është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

2.Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin për Buxhetin Vjetor nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përveç në rastet kur krijohen apo shuhen struktura organizative.

3.Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, dispozitat e Ligjit për Buxhetin Vjetor janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 13

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë:

1.1.Shtojca 1 e cila përmban emërtimin, klasën dhe grupin e pozitive, si dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve;

1.2.Shtojca 2 e cila përmban Organogramin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 31 janar /2024

Shtojca Nr.1: INSPEKTORATI I MINISTRISË SË DREJTËSISË			
Pozita/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri total IMD: 24
1. Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë 2		1
Zyrtar i Lartë Ligjor	Profesional 1	1.Gr. Specialist Ligjor	1
Zyrtar Administrativ	Profesional 3	58 .Gr. specialist i administrimit të Përgjithshëm	1
2.1. Divizioni për Mbikëqyrjen e Qendrave Korrektuese			Totali: 8
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1
Inspektor për inspektimin e Qendrave Korrektuse	Profesional 1	14.Gr. Specialist i shkencave shoqërore	7
2.2. Divizioni për Mbikëqyrjen e Qendrave të Paraburgimit			Totali: 6
Udhëheqësi i Divizionit Për mbikëqyrjen e qendrave të Parburgimit	Drejtues i Ulët		1
Inspektor për inspektimin e qendrave të paraburgimit	Profesional 1	14.Gr. Specialist i shkencave shoqërore	5
2.3. Divizioni për Mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese			Totali: 7
Udhëheqësi i Divizionit për mbikqyrjen e Drejtorive Rajonale Sprovuese	Drejtues i Ulët		1
Inspektor për inspektimin Drejtorive rajonale sprovuese paraburgimit	Profesional 1	14.Gr. Specialist i shkencave shoqërore	6

Shtojca Nr. 2: Organogrami i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë

